



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 27 dhjetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 26 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 12, 14, 16 dhe nenit 23 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr. 1044/2023 të datës 22 dhjetor 2023, shpall:

SHPLLJE E BRENDISHME

Për plotësim me nëntë (9) pozita për prokurorë në Prokurorinë Speciale

I. Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kriteret:

1. Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
2. Të ketë vlerësim të mjaftueshëm ose më të lartë të performancës;
3. Vlerësimi "I mjaftueshëm" sipas Rregullores Nr. 12/2015 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit është pengesë për avancim, deri në vlerësimin e prokurorit sipas Rregullores Nr. 05/2020 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit;
4. Të mos ketë masa disiplinore në pesë (5) vjetët e fundit, përjashtimisht qortimit dhe vërejtjes jopublike;
5. Të mos ketë filluar hetimi penal;
6. Të ketë reputacion të lartë profesional;
7. Me rastin e avancimit do të merren parasysh pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me njohuritë e përgjithshme në procedurë penale, mjetet juridike, praktika juridike e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja akademike, punimet shkencore, ligjërimi në akademi apo në nivel universitar, angazhimi i prokurorit në sistemin prokurorial dhe pjesëmarrja në

projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

II. Përveç kriterëve të përgjithshme kandidatët që aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta si në vijim:

1. Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, prokurori duhet t'i plotësojë kushtet për të punuar si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda, si dhe të ketë vlerësim pozitiv të performancës.

III. Kandidati që aplikon për avancim duhet të plotësojë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit¹ si dhe t'i bashkëngjisin dokumentet si në vijim:

1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;

2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;

3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.

V. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 28 dhjetor 2023 deri më datë 11 janar 2024.

VI. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e gjashtë (6) ndërtesa e Prokurorit të Shtetit, rruga "Luan Haradinaj" - Prishtinë, zyra numër 602, të mbyllura në zarf, ose me postë.

¹ Prokurorët të cilët aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://www.prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.